



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 373 Prot.

Tiranë, më 03.02.2020

VENDIM QARKULLUES

Nr. 8, datë 03.02.2020

**PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TARIFAVE
TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE,
SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK
2019-2020, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, Vendimit Nr. 64, datë 20.11.2019 të Senatit Akademik të UMT-së, i ndryshuar, propozimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2019-2020, janë 296 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë), të ndara si më poshtë:
 - a) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 113;
 - b) Kuota pranimi për Ministrinë e Mbrojtjes 18;
 - c) Kuota pranimi për Ministrinë e Drejtësisë 11;
 - d) Kuota pranimi për Ministrinë e Brendshme 1;
 - e) Kuota të lira 153;
2. Kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën l/a), b), c), d) dhe e), të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Kuotat e pranimit për transferim të studimesh (5 kuota) janë në mbështetje të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Studenti transferohet nga programe specializimi afatgjatë, të ngjashme, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.

- 
4. Aplikojnë, për programe studimi specializuese, afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.
 5. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të udhëzimit përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
 6. Tarifa e aplikimi dhe konkurrimit (intervista me gojë) në programet specializuese afatgjatë apo tarifa e aplikimit për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi është 115000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrimit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifat e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse.
 7. Studenti, i cilësuar, në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik, si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
 8. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas pikës 1/a),b), c) dhe d) të këtij vendimi duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse. Studentët e shpallur fitues në kuotat sipas pikës 1/a),b), c) dhe d) të këtij vendimi lidhin kontratën me ministrinë përkatëse.

Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj, detyrimet, penaltetet në rast mosrespektimi të tyre, është përgjegjësi e ministrive përkatëse, të cilat kanë dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt, para hapjes së procesit të aplikimeve.
 9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njësive kryesore përkatëse të UMT-së, pa efekte buxhetore shtesë.
 10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe i përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë, Dentare, si dhe Ministrive përkatëse dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit tretë, në fushën e mjekësisë.
 11. Vendimi nr.2, datë 29.1.2020 i Senatit Akademik, shfuqizohet.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GLATA



Tabela: Shpërndarja e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2019-2020.

Nr.	Njësia kryesore	Programi i studimit	Kuota të miratuar për vitin akademik 2019-2020 me VSA nr.66	Kuota të propozuara nga MSHMS	Kuota të propozuara nga Ministria e Mbrojtjes	Kuota të propozuara nga Ministria e Drejtësisë	Kuota të propozuara nga Ministria e Brendshme	Kuota të lira pas propozimeve të ministrave përkatëse
1	F. i Mjekësisë	Alergologji dhe imunologji klinike	5		2			3
2	F. i Mjekësisë	Anatomi patologjike	5					5
3	F. i Mjekësisë	Anestezi-reanimacion	15	13				2
4	F. i Mjekësisë	Diagnozë me imazhe	5	2	2			1
5	F. i Mjekësisë	Endokrinologji	5		2			3
6	F. i Mjekësisë	Gastrohepatologji	5					5
7	F. i Mjekësisë	Hematologji	5					5
8	F. i Mjekësisë	Kardiologji	10	10				0
9	F. i Mjekësisë	Kirurgji e përgjithshme	20	10	1			9
10	F. i Mjekësisë	Laborator klinik-biokimik	5		1			4
11	F. i Mjekësisë	Mikrobiologji	5					5
12	F. i Mjekësisë	Mjekësi familje	30	13				17
13	F. i Mjekësisë	Mjekësi interne	10	10				0
14	F. i Mjekësisë	Mjekësi ligjore	5			5		0
15	F. i Mjekësisë	Mjekësi e urgjencës	15	13		1		1
16	F. i Mjekësisë	Mjekësi transfuzive	5					5
17	F. i Mjekësisë	Nefrologji	5		1			4
18	F. i Mjekësisë	Neurologji	6	3	1	1	1	0
19	F. i Mjekësisë	Neurokirurgji	5					5
20	F. i Mjekësisë	Otorinolaringologji	5		2			3
21	F. i Mjekësisë	Obstetrike-gjinekologji	10	10				0
22	F. i Mjekësisë	Okulistike	5		2			3
23	F. i Mjekësisë	Onkologji	10	2				8

24	F. i Mjekësisë	Ortopedi-traumatologji		5	2	2			1
25	F. i Mjekësisë	Pediatri		20	15				5
26	F. i Mjekësisë	Pneumologji		5	2		1		2
27	F. i Mjekësisë	Psikiatri		15	8		2		5
28	F. i Mjekësisë	Psikiatri e fëmijëve dhe adoleshentëve		5					5
29	F. i Mjekësisë	Reumatologji		5		1			4
30	F. i Mjekësisë	Sëmundje infektive		15			1		14
31	F. i Mjekësisë	Shëndet publik		10					10
32	F. i Mjekësisë	Toksikologji klinike		5					5
33	F. i Mjekësisë	Kirurgji plastike, rikonstruktive dhe estetike		5		1			4
TOTAL				286	113	18	11	1	143

Nr.	Njësia kryesore	Programi i studimit	Kuota të miratuara për vitin akademik 2019-2020 me VSA nr.66/Kuota të lira
1	F. i Mjekësisë Dentare	Terapi stomatologjike	5
2	F. i Mjekësisë Dentare	Pedodonti	5
TOTAL			10

***5 kuota për transferim studimesh kërkua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

